# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 14

**Tiranë – E martë, 23 janar 2024**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret i Presidentit nr. 14, datë 16.1.2024 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... | 2225 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 17.1.2024 | Për një ndryshim në vendimin nr. 606, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë"..... | 2225 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 17.1.2024 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin..... | 2225 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 17.1.2024 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit..... | 2226 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 17.1.2024 | Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave..... | 2228 |
| Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1, datë 15.1.2024 | Për miratimin e "Planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK, për vitin 2024"..... | 2229 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 1, datë 19.1.2024 | Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara", të ndryshuar..... | 2255 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 14, datë 17.1.2024 | Për delegim të përkohshëm kompetencash..... | 2258 |
| Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 27, datë 22.1.2024 | Për delegimin e kompetencave ..... | 2258 |

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Veli Balla..... 2259

Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Arjan Qalliu..... 2259

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arjan Elezi..... 2259

**DEKRET**
**Nr. 14, datë 16.1.2024**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93, të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Henri Fejzi Shabani
2. Evagora Vasil Karvella
3. Korab Rrustem Sinanaj
4. Megi Sokol Gjongecaj
5. Erald Fiqiri Kurti
6. Alois Erald Kurti
7. Eralda Serjan Eschedor (Kodhima)
8. Saimir Pasho Bajroni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**VENDIM**
**Nr. 28, datë 17.1.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 606, DATË 20.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 606, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë", fjalët "... në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe ..." hiqen.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 29, datë 17.1.2024**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për administratën publike dhe për luftën kundër korrupsionit.

3. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) drejtimin dhe bashkërendimin e punës për propozimin e akteve dhe politikave, për:

- menaxhimin dhe energjizimin e burimeve njerëzore të administratës publike;

- ndërtimin e institucioneve të administratës shtetërore;

- trajnimin e të punësuarve të administratës publike.

b) drejtimin dhe bashkërendimin e punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

4. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj, me akte të Këshillit të Ministrave dhe nga Kryeministri.

5. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për përmbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë dhe partneritetit për qeverisje të hapur.

6. Ngarkohet ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 30, datë 17.1.2024**

## PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën makro-dhe mikroekonomike, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim garantimin e një rritjeje ekonomike të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Miradministron burimet, harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës e të shërbimeve për biznesin e qytetarin. Promovon dhe orienton drejt risive ndërkombëtare duke maksimizuar suksesin e investimeve. Komandon instrumente administrative ekzekutive të zgjidhjes së konflikteve shtet-privat;

b) garanton të drejtën për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë;

c) harton dhe zbaton politikat e qeverisë në fushën e zhvillimit dhe promovimit të kulturës, trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së dialogut kulturor, integrimit kulturor në familjen evropiane e botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

ç) synon dhe mundëson stimulimin e aktivitetet inovative, të cilat do të rrisin produktivitetin ekonomik dhe institucional përmes zhvillimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit efikas;

d) identifikon koncepte, procese novatore dhe teknika të reja, kryen studime dhe analiza krahasuese për politikat në nivel rajonal e botëror, për të vlerësuar të dhënat në kuadër të hartimit apo zbatimit të politikave qeveritare, me qëllim hartimin e strategjive që mundësojnë zbulimin e mundësive të reja të inovacionit;

dh) në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, bashkërendon dhe zbaton politikat shtetërore që synojnë standarde të larta të shërbimeve publike, të ofruara për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimin e jetesës, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike, sigurimin e cilësisë dhe përballimin e tyre.

3. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

3/1. Lidhur me fushën e ekonomisë:

a) strehimin;

b) punësimin;
c) sigurimet shoqërore;
ç) arsimin dhe formimin profesional;
d) marrëveshjet e tregtisë së lirë;
dh) nxitjen e investimeve;
e) administrimin e pronës shtetërore;
ë) mbështetjen e partneritetit publik privat;
f) regjistrimin dhe licencimin e operatorëve ekonomikë;
g) shërbimin e akreditimit dhe standardizimit;
gj) mirëmbajtjen, kalibrimin dhe inspektimin e mjeteve matëse;
h) pronësinë industriale;
i) mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
j) mbrojtjen e konsumatorëve;
k) zonat ekonomike dhe teknologjike;
l) ndihmën shtetërore dhe garancitë shtetërore.

3/2. Lidhur me fushën e kulturës:

a) harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, rijetësimit të vlerave e të trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal;

b) harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme ligjore e mbështetëse për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve;

c) harton politika për ekzistencën e Shqipërisë, si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse;

ç) udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike e letrare brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimit të vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara edhe ato bashkëkohore e krijimin e një hapësire dialogu mbarëshqiptar e të diversitetit kulturor;

d) realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitoron respektimin e të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet, personat fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore;

dh) zhvillon politika për nxitjen e investimeve për pasuritë kulturore, siguron mbështetje financiare nëpërmjet Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, qendrat art e zeje në shkolla, si dhe për formimin në vazhdim për të licencuarit në pasuritë kulturore materiale.

3/3. Lidhur me fushën e inovacionit:

a) synon dhe mundëson stimulimin e aktiviteteve inovative, të cilat do rrisin produktivitetin ekonomik dhe institucional përmes zhvillimit të teknologjisë informative dhe bashkëpunimit efikas;

b) identifikon koncepte, procese novatore dhe teknika të reja, kryen studime dhe analiza krahasuese për politikat në nivel rajonal e botëror për të analizuar të dhënat në kuadër të hartimit apo zbatimit të politikave qeveritare, me qëllim zhvillimin dhe hartimin e analizave strategjike, që mundësojnë zbulimin e mundësive të reja të inovacionit;

c) orienton:

i. promovimin e inovacionit dhe të teknologjisë informative në shërbim të rritjes ekonomike dhe zhvillimit;

ii. zhvillimin e bashkëpunimit përmes programeve të trajnimit/ konsulencës;

iii. konsolidimin e fondit për shërbimet inovative për përkrahje të sektorëve zhvillimorë të ekonomisë;

iv. krijimin e mekanizmave institucionalë koordinues ndërmjet shkencës, sektorit privat dhe politikëbërjes.

ç) në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, zhvillon dhe monitoron, politikat shtetërore dhe strategjitë për:

i. sigurimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve publike;

ii. rritjen e cilësisë së shërbimeve në çdo sektor publik;

iii. lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike;

iv. rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të garantuar aksesin e qytetarëve në marrjen e shërbimeve publike.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 2.3.2022, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë", dhe nr. 607, datë 20.10.2021, "Për

përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës", shfuqizohen.

5. Ngarkohet ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 31, datë 17.1.2024**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Financave është arritja e stabilitetit ekonomik, nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

3. Ministria e Financave e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) politikën makrofiskale;

b) administrimin e të ardhurave;

c) administrimin e buxhetit të shtetit;

ç) menaxhimin e borxhit publik dhe garancive shtetërore të huas;

d) administrimin financiar;

dh) menaxhimin financiar dhe kontrollin;

e) menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian;

ë) inspektimin financiar publik;

f) bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm;

g) parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit;

gj) lojërat e fatit.

4. Ministria e Financave, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3, të këtij vendimi, është përgjegjëse për:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale e buxhetore, në të cilat përfshihen analizat makrofiskale, parashikimi i të ardhurave, politika e shpenzimeve publike, politika e tatimtaksave, politika e borxhit publik;

b) mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e nismave e të hapave ligjorë, me qëllim administrimin e të ardhurave, në të cilat përfshihen, kryesisht, administrimi i taksave dhe administrimi doganor;

c) hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, kontrolli i menaxhimit të investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë;

ç) menaxhimin e borxhit publik, në të cilin përfshihen menaxhimi i portofolit të huamarrjes së brendshme e të huaj, menaxhimi i riskut të huamarrjes, si dhe shërbimi i regjistrimit të borxhit;

d) ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit financiar e të kontrollit në të gjitha njësitë e sektorit publik, nëpërmjet vendosjes së rregullave, standardeve, procedurave dhe monitorimit të zbatimit të tyre;

dh) miradministrimin financiar të fondeve publike, i cili realizohet nëpërmjet ushtrimit të funksionit të thesarit, zbatimit të metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik dhe kontrollit të brendshëm financiar publik;

e) menaxhimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian, sigurimin e bashkëfinancimit, ndjekjen e zbatimit të kontratave, legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe funksionimin e efektshëm të sistemeve të menaxhimit të kontrollit, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA);

ë) inspektimin financiar publik, si funksion i parashikuar me qëllim:

i. mbrojtjen e interesave financiare të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit;

ii. rregullshmërinë e transaksioneve e të veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar publik;

iii. përcaktimin e shkeljeve të akteve normative, si dhe dyshimeve për mashtrimet e kryera;

iv. zbulimin e parregullsive e të dëmeve të shkaktuara në pronën e njësive publike;

v. identifikimin e shkeljeve e të individëve përgjegjës për parregullsitë e zbuluara.

5. Ministria e Financave është institucioni i vetëm që bën bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm nëpërmjet hartimit dhe miratimit të politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditit të brendshëm.

6. Ministria e Financave ka rol të përgjithshëm këshillues në interes të politikave qeveritare për promovimin e efektshmërisë, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik dhe në ato institucione financiare në të cilat qeveria merr pjesë.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**UDHËZIM**
**Nr. 1, datë 15.1.2024**

**PËR MIRATIMIN E "PLANIT KOMBËTAR TË KONTROLLEVE ZYRTARE ME BAZË RISKU DHE TË MARRJES SË MOSTRAVE PËR USHQIMIN, USHQIMIN PËR KAFSHË, MBROJTJEN E BIMËVE DHE INPUTEVE BUJQËSORE, SI DHE PLANIN E MARRJES SË MOSTRAVE NË PIK, PËR VITIN 2024"**

Në mbështetje të nenit 102, të pikës 4, të Kushtetutës, të pikës 7, të nenit 43, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar dhe pikës 7, të kreut II, të vendimit nr. 532, datë 11.9.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve",

UDHËZOJ:

1. Miratimin e "Planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planit të marrjes së mostrave në pikat e inspektimit kufitar, për vitin 2024", që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Drafti i "Planit kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe i marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planit të marrjes së mostrave në pikat e inspektimit kufitar", për vitin 2025, të dorëzohet në ministri brenda muajit tetor 2024.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Anila Denaj**

**PLANI KOMBËTAR I KONTROLLEVE ZYRTARE ME BAZË RISKU DHE I MARRJES SË MOSTRAVE PËR USHQIMIN, USHQIMIN PËR KAFSHË, MBROJTJES SË BIMËVE DHE INPUTEVE BUJQËSORE, SI DHE PLANI I MARRJES SË MOSTRAVE NË PIK**

**Tabela e përmbajtjes**

1. Hyrje
1.1 Historiku, qëllimi dhe objektivat
2. Profilizimi i riskut të operatorëve të biznesit
2.1 Metodologjia
3. Regjistrimi dhe kategorizimi i operatorëve të biznesit
3.1 Përditësimi i regjistrit të operatorëve të biznesit
3.2 Plani i kontrollit zyrtar vjetor në bazë risku dhe i marrjes së mostrave
3.3 Kategorizimi i operatorëve të biznesit
4. Përllogaritjet mbi numrin e kontrolleve zyrtare
5. Portali i hedhjes së të dhënave "e-Inspektimi"
6. Plani i marrjes së mostrave gjatë kontrolleve zyrtare në terren dhe në PIK

6.1 Përllogaritja e numrit të mostrave dhe analizave 15
7. Plani i monitorimit të mbetjeve të pecticideve për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
8. Referenca
Aneks

**LISTA E TABELAVE**

Tabela nr. 1. Përcaktimi i frekuencave minimale vjetore të inspektimit
Tabela nr. 2. Përcaktimi i frekuencave minimale vjetore të inspektimit të operatorëve e bizneseve që operojnë në fushën e inputeve bujqësore
Tabela nr. 3. Klasifikimi i operatorëve të biznesit ushqimor që prodhojnë, përpunojnë produkte me origjinë shtazore dhe joshtazore
Tabela nr. 4. Kategorizimi i operatorëve të biznesit të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore
Tabela nr. 5. Ndryshimi i numrit të OBU-ve në pesë vitet e fundit për operatorët e biznesit ushqimor dhe operatorët e biznesit të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore
Tabela nr. 6. Kategoria e riskut për çdo DRAKU për vitin 2024 për OBU dhe OB
Tabela nr. 7. Përllogaritja specifike e numrit të kontrolleve zyrtare të planifikuara për vitin 2024 nga DRAKU, në bazë të kategorizimit të riskut të OBU-së dhe OB-së
Tabela nr. 8. Planifikimi i mostrave në Sektorët e Shërbimit Laboratorik AKU, ISUV dhe DSHP nga Sektori i Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për kafshë dhe OBU, sipas DRAKU-ve.
Tabela nr. 9. Planifikimi i mostrave në Sektorët e Shërbimit Laboratorik AKU, ISUV, ESHFF, QTTB nga sektori i kontrollit të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore
Tabela nr. 10. Planifikimi i mostrave në sektorët e shërbimit laboratorik AKU dhe ISUV nga Sektori i Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK).
Tabela nr. 11. Ndarja e mostrave sipas muajve "Plani i monitorimit të mbetjeve të pesticideve në terren"
Tabela nr. 11.1. Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.2. Fier: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.3. Durrës: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.4. Elbasan: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.5. Tiranë: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.6. Gjirokastër: Shpërndarja për periudhën janar 2024 - dhjetor 2024
Tabela nr. 11.7. Korçë: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.8. Vlorë: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.9. Shkodër: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.10. Kukës: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.11. Dibër: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.12. Lezhë: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.13. Plani i monitorimit të mbetjeve të pesticideve në Pikat e Inspektimit Kufitar.
Tabela nr. 11.14. PIK Durrës: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.15. PIK Kakavijë: Shpërndarja për periudhën janar 2024 - dhjetor 2024
Tabela nr. 11.16. PIK Kapshticë: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.17. PIK Morinë: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.18. PIK Qafëthanë: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024
Tabela nr. 11.19. PIK Hani i Hotit: Shpërndarja për periudhën janar 2024–dhjetor 2024

## 1. HYRJE

1.1 HISTORIKU, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Misioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është garantimi i sigurisë dhe i cilësisë së ushqimeve, dhe i ushqimeve për kafshë në të gjithë zinxhirin e saj, sigurinë e shëndetit të kafshëve dhe të bimëve, si dhe produkteve bimore në pikat e inspektimit kufitar dhe shëndetit të bimëve e të produkteve bimore, kur ato kanë dalë në treg, në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet kryerjes së veprimtarive inspektuese, teknike dhe shkencore në këtë fushë.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, sigurinë e shëndetit të kafshëve në pikat kufitare dhe shëndetit të bimëve e të produkteve bimore, kur ato kanë dalë në treg, është

person juridik publik, me seli në Tiranë, që ushtron aktivitetin e tij në të gjithë territorin e vendit, i organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal nëpërmjet Drejtorive Rajonale në 12 qarqe.

Për arritjen e këtyre objektivave, AKU-ja ka detyrime specifike për kryerjen e kontrolleve zyrtare ndaj subjekteve që operojnë në fushën e ushqimit dhe të inputeve bujqësore, kryerjen e vlerësimit të riskut në fushën e sigurisë ushqimore, menaxhimit dhe komunikimit të tij.

Nga viti 2015, AKU-ja i kryen kontrollet zyrtare në zbatim të planit vjetor të inspektimeve, i cili miratohet nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku vlen të përmendet se hartimi i planit për vitin 2023–2024 sjell risi, pasi është kryer mbi një metodologji të mirëfilltë për profilizimin e riskut të çdo OB-je referuar historikut të tyre. Ky plan ka si qëllim kryerjen e kontrolleve zyrtare në operatorët e biznesit bazuar vlerësimit individual, me qëllim kategorizimin e riskut në varësi të riskut të tyre, si dhe frekuencat e përshtatshme të inspektimeve të kontrolleve zyrtare për OB-të në bazë të rezultateve të procesit të kategorizimit.

Objektivat kryesorë të Planit të Kontrollit Zyrtar Vjetor dhe Plani i Marrjes së Mostrave, për vitin 2024 janë:

- Zbatimi i rregullave të sigurisë ushqimore përmes kontrolleve zyrtare të përmirësuara, përfshirë kushtet e kontrollit;

- Organizimi i kontrolleve zyrtare, monitorimi dhe verifikimi për përmbushjen e kërkesave ligjore nga operatorët e biznesit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe joshtazore në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, magazinimit dhe shpërndarjes, nga operatorët e biznesit të mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe zbatimit me rigorozitet të kuadrit ligjor dhe rregullativ;

- Kryerja e kontrolleve zyrtare sipas planit të marrjes së mostrave, bazuar në vlerësimin e riskut dhe frekuencën e përcaktuar;

- Efikasitet, cilësi dhe nivel të lartë transparence të kontrolleve zyrtare në nivel kombëtar dhe lokal;

- Përfshirja e planit të pesticideve në planin zyrtar vjetor;

Plani i kontrollit zyrtar vjetor dhe marrjes së mostrave për vitin 2024 u hartua duke marrë parasysh:

- të dhënat për operatorët e biznesit;

- indikatorët specifikë për vlerësimin e riskut referuar metodologjisë së re (shpjeguar në sesionin 2);

- kapacitetet aktuale laboratorike në AKU dhe ISUV; si dhe

- në modulin e programimit vjetor në portalin *"e-Inspektimi"* të IQ.

**2. PROFILIZIMI I RISKUT TË OPERATORËVE TË BIZNESIT**

2.1 METODOLOGJIA

Kontrollet zyrtare duhet të kryhen në të gjitha fazat e zinxhirit të prodhimit, përpunimit, shpërndarjes, ruajtjes dhe tregtimit.

Për arritjen e objektivave, me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore duhet që autoriteti kompetent të kryejë kontrolle zyrtare në të gjithë operatorët rregullisht, sipas riskut dhe me frekuencën e përshtatshme, duke marrë parasysh:

"a) risqet e identifikuara të lidhura me:

i. kafshët dhe produkte;

ii. aktivitetet që janë nën kontrollin e operatorëve;

iii. vendndodhjen e aktiviteteve ose operacioneve (veprimtarive) të operatorëve;

iv. përdorimin e produkteve, proceseve, materialeve ose substancave që mund të ndikojnë në sigurinë dhe integritetin e ushqimit, ushqimit për kafshë, shëndetin e bimëve;

b) çdo informacion që mund të tregojë se ka gjasa që konsumatorët mund të mashtrohen, veçanërisht për natyrën, identitetin, veçoritë, përbërjen, sasinë, shtetin e origjinës ose vendin e prejardhjes, metodën e prodhimit të ushqimit ose prodhimit të inputeve bujqësore, duhanit dhe nënprodukteve të tij;

c) historikun e shkuar të operatorëve, në lidhje me rezultatin e kontrolleve zyrtare të kryera mbi to dhe përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi;

ç) besueshmërinë dhe rezultatet e kontrolleve vetjake që janë kryer nga operatorët, ose nga palët e treta me kërkesë të tyre, duke përfshirë, ku është e përshtatshme, skemat private të garantimit të cilësisë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me kërkesat e legjislacionit në fuqi; dhe

d) çdo informacion që mund të tregojë se ka mospërputhshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Me qëllim bashkërendimin me kërkesat legjislative të BE-së, të gjitha stabilimentet nën kontrollin zyrtar të AKU-së, iu nënshtruan procesit

të vlerësimit të riskut e për rrjedhojë rikategorizimit bazuar historikut të tyre.

Stabilimentet mund të kategorizohen me risk të ulët, të mesëm ose të lartë, në varësi të riskut që lidhet me aktivitetet e tyre dhe faktorëve të tjerë ndikues, duke përdorur sistemin e pikëzimit të përcaktuar në këtë dokument. Kjo njihet si Kategoria e Përgjithshme e Riskut të Stabilimentit.

Kategoria e Përgjithshme e Riskut të Stabilimentit[1] (efekti i natyrës së operacioneve (veprimeve) mbi kategorinë e riskut) llogaritet duke marrë në konsideratë si faktor madhor, aktivitetet e stabilimentit. Ky faktor bazohet në aktivitetin ose aktivitetet kryesore që ndodhin në stabiliment dhe llojet e produkteve me të cilat merret stabilimenti. Disa aktivitete/produkte kanë natyrshëm risk më të lartë se të tjerat, nga pikëpamja e sigurisë ushqimore.

**Aktivitetet klasifikohen si:**
**Aktivitete me risk të ulët, risk të mesëm ose risk të lartë**

Faktorët ndikues:
- Shkalla e operimit/e shpërndarjes;
- Ambientet dhe vendndodhja;
- Profilit të konsumatorëve ose subjekte që i shërbejnë konsumatorit;
- Gjasat që konsumatorët/përdoruesi/blerësi të mashtrohen;
- Sistemi i brendshëm i kontrollit;
- Aftësia menaxhuese (duke përfshirë historikun e përputhshmërisë);
- Faktorë të tjerë (p.sh. sezoni, auditime të palëve të treta nga autoritetet kompetente ose organet e respektive të certifikimit).

**Sistemi i pikëzimit:**
**Pikëzimi i riskut të aktivitetit + Pikëzimi i faktorëve ndikues = Pikëzimi i riskut të përgjithshëm**

**Aktivitetet e shumëfishta:**

Nëse një stabiliment kryen më shumë se sa një lloj procesi dhe ato kanë nivele të ndryshme bazë risku, stabilimentit duhet t'i caktohet niveli më i lartë bazë i riskut.

Kategoria e Përgjithshme e Riskut të Stabilimentit përllogaritet duke marrë në konsideratë si faktor kryesor aktivitetet e stabilimentit dhe një sërë faktorësh ndikues.

Për sa u përket aktiviteteve të zhvilluara, stabilimentit i caktohet një **Pikëzim i riskut të aktivitetit** 1, 2 ose 6 **(pika A)** ku:
- 1 për aktivitet me risk të ulët
- 2 për aktivitet me risk të mesëm
- 6 për aktivitet me risk të Lartë.

Për përcaktimin e pikës A, është plotësuar formulari i vlerësimit të riskut[2].

- Nëse të gjitha aktivitetet janë vetëm me risk të ulët (d.m.th. jo me risk të mesëm ose të lartë), risku i aktivitetit është i ulët, me **pikë A** të barabartë me 1.

- Nëse një ose më shumë aktivitete janë me risk të mesëm, pa aktivitete me risk të lartë, risku i aktivitetit është i mesëm, me **pikë A** të barabartë me 2.

- Nëse një ose më shumë aktivitete janë me risk të lartë, risku i aktivitetit është i lartë, me **pikë A** të barabartë me 6.

**Faktorët ndikues**, si: shkalla, ambientet dhe vendndodhja, sistemet e kontrollit, aftësia menaxhuese dhe gjasat që konsumatorët/fermerët të mashtrohen duhet të pikëzohen secili nga +1 në +5, ku +1 është risku më i ulët dhe +5 është risku më i lartë.

- Sipas rastit, faktorët e tjerë duhet të pikëzohen nga -3 në +5, ku -3 caktohet për faktorët e identifikuar, që reduktojnë ndjeshëm riskun, deri në +5 për faktorët e identifikuar që rrisin ndjeshëm riskun.

Shuma e këtyre pikëzimeve (d.m.th. **Pikëzimi i faktorëve ndikues në total**) është **pika B.**

Më pas, **Pikëzimi i riskut të përgjithshëm** mund të përcaktohet duke mbledhur Pikëzimin e riskut të aktivitetit me Pikëzimin e faktorëve ndikues në total (formulari i vlerësimit të riskut), pra:

[1] Ky është modeli ekzistues i AKU-së (d.m.th., duke përdorur riskun e stabilimentit). AKU-ja ka zgjeruar tashmë modelin e saj të riskut, duke rivlerësuar riskun e aktivitetit të stabilimentit dhe më pas, në modelin ekzistues, janë shtuar faktorët ndikues.

[2] Tabela *Excel* për profilizimin e riskut bazuar në historikun e subjekteve.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ☐ | + | ☐ | = | ☐ |
| PIKA A (Pikëzimi i riskut të aktivitetit nga hapi 1) | | PIKA B (Pikëzimi i faktorëve ndikues në total nga hapi 2) | | PIKËZIMI I RISKUT TË PËRGJITHSHËM |

**Kategoria e Përgjithshme e Riskut të Stabilimentit** mund të përcaktohet si vijon:
- Stabilimenti me risk të ulët do të ketë një pikëzim risku të përgjithshëm < 10;
- Stabilimenti me risk të mesëm do të ketë një pikëzim risku të përgjithshëm nga 10 në 14;
- Stabilimenti me risk të lartë do të ketë një pikëzim risku të përgjithshëm > 14.

Në vazhdimësi, DRAKU duhet të kryejë rishikime të vlerësimeve të riskut për të gjitha stabilimentet në bazë vjetore (ose më shpesh nëse nevojitet, p.sh. në rastin e konstatimit të mospërputhshmërisë së konsiderueshme, ndryshimit të aktiviteteve).

* Drejtoritë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit mund të kryejnë ndryshimin e subjekteve të planifikuar në planin kombëtar me bazë risku, në rast se këto subjekte nuk gjenden fizikisht në terren, duke ushtruar aktivitetin, me subjekte të reja të hapura rishtazi, për të cilat nuk është kryer planifikimi në vitin aktual, si dhe pas kryerjes së inspektimit do të planifikohen në vijim sipas riskut përkatës.

**Tabela nr. 1. Përcaktimi i frekuencave minimale vjetore të inspektimit**

Frekuenca vjetore e inspektimit për inspektimet rutinë të AKU-së
Rregulla të përgjithshme:
**- Inspektimet në përgjigje të ankesave ose incidenteve/riinspektimet/asgjësimit/jokonformite, licencim, RASFF etj., të produkteve ushqimore, duhet të trajtohen si inspektime shtesë dhe të veçanta nga frekuencat e përcaktuara më poshtë.**
**- Inspektimet duhet të kryhen pa lajmërim.**
**- Bizneset sezonale: Disa veprimtari funksionojnë vetëm në mënyrë sezonale. Gjatë marrjes në konsideratë të përcaktimit të kohës së inspektimit të këtyre bizneseve ushqimore, AKU-ja ka marrë masa të kryejë planifikimin në periudhën e ushtrimit të veprimtarisë.**

| Lloji i stabilimentit | Frekuenca e inspektimit |
|---|---|
| Stabilimentet me risk të ulët | 1 inspektim çdo 18 muaj |
| Stabilimentet me risk të ulët – që prodhojnë ushqime "Gati për konsum" | 2 inspektime çdo 18 muaj |
| Stabilimentet me risk mesatar | 1 inspektim në vit |
| Stabilimentet me risk mesatar – që prodhojnë ushqime "Gati për konsum" | 2 inspektime në vit (1 inspektim çdo 6 muaj) |
| Stabilimentet me risk të lartë | 3 inspektime në vit (1 inspektim çdo 4 muaj) |
| Stabilimentet me risk të lartë – që prodhojnë ushqime "Gati për konsum" | 4 inspektime në vit (1 inspektim çdo 3 muaj) |
| Stabilimentet e miratuara për eksport drejt BE-së | Minimumi 1 inspektim i plotë në muaj (12 në vit) |

FREKUENCA MINIMALE E INSPEKTIMIT:

(Plotësohet duke iu referuar tabelës së mësipërme)

☐ **Numri i inspektimeve në vit**

**Tabela nr. 2. Përcaktimi i frekuencave minimale vjetore të inspektimit të operatorëve e bizneseve, që operojnë në fushën e inputeve bujqësore**

| Frekuenca vjetore e inspektimit për inspektimet rutinë të AKU-së<br>Rregulla të përgjithshme:<br>**- Inspektimet në përgjigje të ankesave, hetimeve etj. duhet të trajtohen si shtesë dhe të ndara nga frekuencat e përshkruara më poshtë.**<br>**- Inspektimet duhet të jenë të paparalajmëruara.**<br>**- Inspektimet PMB duhet të përfshijnë një kontroll, sa vijon:**<br>**- të gjitha produktet në magazinë të regjistruara në MBZHR;**<br>**- kontrollet e etiketës së të gjitha produkteve në magazinë kundrejt informacionit të regjistruar për produktin me MZHBR-në (p.sh. përdorimi i duhur i të korrave, përbërësit aktivë etj.).** | |
|---|---|
| Lloji i stabilimentit | Frekuenca e inspektimit |
| Stabilimentet me risk të ulët | 1 inspektim gjatë periudhës 1-vjeçare (inspektim dhe marrje mostrash) |
| Stabilimentet me risk mesatar | 2 inspektime në vit (inspektim çdo 6 muaj dhe marrje mostrash) |
| Stabilimentet me risk të lartë | 4 inspektime në vit/inspektimi tremujor (inspektimi dhe marrje mostrash) |
| FREKUENCA MINIMALE E INSPEKTIMIT:<br><br>(Plotësohet duke iu referuar tabelës së mësipërme)<br><br>☐ **Numri i inspektimeve në vit** | |

* Profilizimi i riskut të operatorëve të bizneseve shqiptare që operojnë në fushën e inputeve bujqësore nën mbikëqyrjen e AKU-së, bazohet në të njëjtën sistem pikëzimi por ndryshon në faktorët që kontribuojnë në kategorinë e përgjithshme të riskut të stabilimentit.

## 3. REGJISTRIMI DHE KATEGORIZIMI I OPERATORËVE TË BIZNESIT

3.1 PËRDITËSIMI I REGJISTRIT TË OPERATORËVE TË BIZNESIT

Në kuadër të përgatitjes së Planit të Kontrolleve Zyrtare dhe Marrjes së Mostrave për vitin 2024, secila DRAKU ka përditësuar regjistrin e operatorëve të biznesit të qarkut përkatës.

Përditësimi i regjistrit është realizuar duke u bazuar në:

- ☐ Regjistrin numerik të operatorëve të biznesit referuar të dhënave të planit të kontrolleve zyrtare dhe marrjes së mostrave për vitin 2023, duke verifikuar edhe statusin aktual të OBU-ve/OB, të cilat janë objekt kontrolli i AKU-së.
- ☐ Largimin nga lista e OBU-ve/OB objekt kontrolli, të cilat nga inspektimet e kryera gjatë vitit 2023 e viteve paraardhëse kanë rezultuar të mbyllura, iu është revokuar licenca apo nga verifikimet përkatëse edhe në regjistrin e QKB-së kanë rezultuar me aktivitet të mbyllur, ose kanë tjetërsuar aktivitetin (nga aktivitet në fushën e ushqimit në fusha të tjera që nuk kanë të bëjnë me të).
- Shtimin e numrit të OBU-ve/OB-ve që janë inspektuar për herë të parë gjatë vitit 2023 (si rrjedhojë ose të njoftimit të bërë nga vetë subjekti për hapje aktiviteti, përfshirë kërkesat për t'u pajisur me licencën përkatëse ose nga denoncimet e ndryshme).
- ☐ Verifikimin e listës së OBU-ve/OB për të shmangur dublikimin e tyre.
- ☐ Verifikimin e të dhënave periodike mbi importet (emrin e subjektit importues si dhe destinacionin e ngarkesës) dhe në rastet kur evidentohen subjekte të cilat nuk kanë qenë në regjistrin e vitit paraardhës është kryer pasqyrimi i tyre sipas kategorisë përkatëse në draftplanin e ri.
- ☐ Duke qenë se siguria ushqimore është një proces dinamik, edhe përditësimi i listave të OBU-ve/OB, natyrisht që do të jetë një proces i vazhdueshëm, ndaj vlen të theksohet fakti që OBU-të/OB-të, të cilat do të regjistrohen rishtazi gjatë vitit 2024 do t'i shtohen këtij plani duke kryer vlerësimin individual për çdo OB bazuar në risk.

3.2 PLANI I KONTROLLIT ZYRTAR VJETOR NË BAZË RISKU DHE I MARRJES SË MOSTRAVE

Ky plan përcakton saktë objektin e kontrollit, d.m.th. numrin e operatorëve të biznesit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe joshtazore (OBU), të operatorëve të biznesit në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, duhanit dhe produkteve të tij, si dhe kategorizimin e riskut, i cili bën të mundur:

a) regjistrimin e saktë elektronik të OBU-së dhe OB-së;

b) planifikimin e inspektimeve në përputhje me procedurat e miratuara të inspektimeve në OBU dhe OB, si dhe përllogaritjen e numrit të inspektimeve duke u nisur edhe nga kohëzgjatja e një inspektimi;

c) përcaktimin individual të riskut bazuar historikut të tyre;

ç) efikasitet, cilësi dhe nivel të lartë transparence të kontrolleve zyrtare në nivel kombëtar dhe lokal;

d) rritjen e efikasitetit të raportimeve dhe përpunimit të bazës së të dhënave;

dh) marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave bazuar kapaciteteve aktuale laboratorike të laboratorëve të kontrollit zyrtar, referencës ISUV, ESHFF dhe QTTB.

3.3 KATEGORIZIMI I OPERATORËVE TË BIZNESIT

Në total për vitin 2024 janë 23823 OBU dhe OB të ndara sipas sektorëve, si më poshtë vijon:

Tabela më poshtë pasqyron kategorizimin e operatorëve të biznesit ushqimor që ushtrojnë veprimtari në sektorin e kontrollit zyrtar të ushqimit, ushqimit për kafshë për produkte me origjinë shtazore dhe origjinë joshtazore.

Si rrjedhojë e procesit të përditësimit në regjistrin e OBU-ve të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore/joshtazore për vitin 2024 rezultojnë 20943 subjekte nga 21292 subjekte që përmbante regjistri i vitit 2023, pra kemi një ulje të numrit të subjekteve prej 305 apo 1.64 % më pak.

**Tabela nr. 3. Klasifikimi i operatorëve të biznesit ushqimor që prodhojnë, përpunojnë produkte me origjinë shtazore dhe joshtazore**

